



## "Prag"

Pjesë sociale e dramatizuar, kushtuar sfidës së grave të dhunuara shqiptare, në kërkim të identitetit të tyre, me ndihmën e Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare.

Përgatiti: Ben Andoni  
Udhëheqëse Artistike: Aneta Malaj

Pjesa social-teatrale "**Prag**" u shfaq me sukses në disa njësi vendore të vendit. Këto aktivitete u organizuan nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare në kuadrin e zbatimit të projektit "*Forcimi i grave në nevojë dhe rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit në adresimin e diskriminimit gjinor dhe dhunës në familje përmes dramatizimit dhe performancës*", i cili mbështetet nga *Civil Rights Defenders*, partner në projekt. "**Prag**" u shfaq në rrethet Tiranë, Lezhë dhe Vlorë.

Në datën 18 Dhjetor 2014 u zhvilluan dy aktivitete në ambientet e Bashkisë Vlorë, përkatësisht në orën 10:00 dhe 12:00. Në këto aktivitete, morën pjesë rreth 101 të ftuar, nxënës, pjesëtarë të komunitetit dhe përfaqësues të institucioneve, të cilët ndoqën shfaqjen me mjaft interes dhe në përfundim të saj zhvilluan diskutime aktive mbi çështjet që trajtoheshin në këtë pjesë.



Foto nga shfaqja "Prag", në ambientet e Bashkisë Vlorë